

KOMENTE TE DHOMES SE TREGTISE &INDUSTRISE TIRANE
MBI PROJEKT LIGJIN E RI TE FISKALIZIMIT
Shtator 2019

- 1) Projekt ligji i ri per Fiskalizimin, qe shtrohet sot per diskutim dhe per 3-4 muaj pretendohet te vihet ne zbatim kur vendet e BE-s e kane hedhur per diskutim ne 2008 dhe kane vene ne zbatim ligjin ne vitin 2014,si dhe e kane implementuar faturimin elektronik me etapa sikur Italia.

-
- Etapa e pare per tenderat publike Publik tek Biznesi,
- Etapa e dyte Biznes tek Biznes dhe etapa e trete e cila perfundoi ne korrik/2019 biznes tek Konsumatori.
- Bazuar ne raportin e vleresimit te ndikimit qe do te ketë ligji i ri i fiskalizimit, mendojme qe nuk eshte shqyrtuar vlerësimi i ndikimit qe do të ketë ky ligj.

Edhe pse është komunikuar që ky ligj ose me saktë dispozitat për e-Faturën është marrë nga Direktiva 2014/55/KE e Parlamentit Evropian, modeli i propozuar nuk është përshtatur ne te gjitha elementet e saj me infrastrukturën që kemi në Shqipëri .

- 2) Afati nga prezantimi e diskutimi e deri ne implementim, qe mendohet fillim vitit te ardhshem, eshte shume i shtrenguar. Duke nisur nga data **1 Janar 2020**, të gjitha transaksionet midis Bizneseve dhe Konsumatorit do të raportohen tek Administrata Tatimore në kohë reale, bazuar në sistemin e ri të pajisjeve fiskale, ndërsa nga **1 Janari 2021**, të gjitha transaksionet ndërmjet biznesit me njëri – tjetrin dhe ndërmjet biznesit me organet publike do të bëhen në bazë të faturës elektronike. Shtete te tjera, vetem per te futur faturen elektronike kane shfazuar procesin deri edhe ne kater vite kalendarike (Franca psh).
- 3) Nuk janë vetëm **bizneset** që nuk janë gati për të adaptuar një ligj të tillë, por është edhe vetë **Administrata Tatimore**,jane edhe vete **Bankat**, pasi edhe këto të fundit do të jenë një aktor kryesor në zinxhirin e transaksioneve
- 4) Persa i takon rendeses se legjislacionit kjo eshte evidente, sidomos pjesa e procedurave do te dublohet e mbingarkohet. **Paqartesia dhe subjektiviteti do te rriten kur shikon qe ne cdo nen i lejohet Ministrise se Ekonomise dhe Financave te nderhyje, ne emer te sqarimeve,** por qe mund te sjelle efekt te kundert. Mendojme se komplikohet baza ligjore
- 5) Konfuze situata persa i takon koston e biznesit. Ministria eshte e paqarte dhe me shume mban qendrim deklarativ, pa dhene nje qendrim final e e te sakte.
- 6) E dyshimte infrastruktura mbeshetese. Ne nje vend qe nuk mbulohet teresisht me internet e veshtire te implementosh te tille sistem.Kjo do te krijojë problem ne shume plane.

Tatimpaguesi do duhet që brenda 48 orëve, duke filluar nga data e ndërprerjes së lidhjes, të vendosë një lidhje elektronike (interneti) dhe t'ia dorëzojë të gjitha faturat e lëshuara, administratës tatimore, nëpërmjet një protokolli të veçantë. Kjo jo vetëm është në kufijtë e pamundësisë por edhe një kosto shtesë për cdo tatimpagues.

A i kanë llogaritur efektet ligjberesit?

- 7) Kufiri i parase CASH është shumë i ulët, sidomos bizneset e mikronjesive por edhe me të mëdha se këto.
- 8) Në ligj nuk merren parasysh pagesat që bëjnë me para në dorë biznesi, të cilat janë një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të biznesit. **Është e pamundur që të operohet teresisht me anën e llogarive bankare vetëm.**
- 9) Po me subjekte eksportuese si do të trajtohet praktikisht, lëshimi i fatures elektronike? **B&P**
- 10) Shumë biznese janë në distancë të largët nga bankat. Në fshatra akoma më e rëndë kjo situatë. Çfarë do të duhet të bëjë një biznes? Të mbyllë 3-5 orë punën për cdo ditë?
- 11) Shërbimi brenda vete bankës është i kushtueshëm, qoftë përsa i takon pritjes në rrathë për të edërgdhur/terhequr para, qoftë kur të vijë puna e ngarkimit me komisione të shërbimeve bankare, që pavarësisht se nuk po i përmendin, ato do të ndodhin.
- 12) Implementimi i sistemit do të jetë problematik. Këtë e kemi hasur si kur u implementua sistemi elektronik i tatimeve në vitin 2015, por edhe se fundi me dërgimin e pasqyrave e të dhënave tek QKB.
- 13) Shumë tatimpagues, aktualisht kanë në përdorim software për regjistrimin dhe kontabilizimin e çdo veprimi financiar që shoqëria kryen (duke përfshirë fatura shitje dhe blerje). Pajisjet elektronike të faturimit apo zgjidhja e certifikuar softwar që do të mundësojë lëshimin e faturës elektronike sipas parashikimeve të nenit 18, do të duhet të lidhet dhe integrohet me software që biznesi ka në përdorim.
- 14) **Duke mos njohur zgjidhjen softwerike që do të aplikohet për lëshimin e faturës elektronike,** është e paqartë nëse do të jetë e mundur lidhja dhe integrimi i këtij softueri me sistemet që bizneset kanë në përdorim pa implikuar kosto të konsiderueshme shtesë në ngarkim të subjekteve. Shumë prej ofruesve të shërbimeve për konsumatorët kanë sisteme të komplikuar të menaxhimit të klientëve për të cilat modifikimi apo shtesa e moduleve kërkon kohë shumë më të gjatë sesa 2 – 3 muaj që parashikohet në projektligj.
- 15) Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes. Rezulton se në platformën qendrore do të regjistrohen të gjitha faturat e shitjes dhe të blerjes të tatimpaguesit dhe sistemi informatik i administratës tatimore do të gjenerojë një libër shitje dhe një libër blerje. Por gjithsesi Librat e shitjes dhe të blerjes duhet të shqyrtohen nga tatimpaguesi deri në një afat të caktuar.

Po, kur të behen korrigjime të detyrueshme si është mendur në ligj apo sistem?

- 16) Në shitjet me leke në dorë që sot detyrimisht mbështeten nga pajisjet fiskale, cdo biznes ka shpenzuar si për blerjen e pajisjeve edhe mirëmbajtjen e tyre. Asnjë qartësim nuk jepet se cdo të bëhet me pajisjet ekzistuese. Që do të ketë një kosto shtesë, çfarëdo lloj aplikacionesh të hidhen në qarkullim kjo nuk ka dyshim. Por përse biznesi do të paguajë?